

# Match<sup>®</sup> 050 EC

**Lënda vepruese:** Lufenuron  
**PËRMBAJTJA:** Lufenuron: 5%  
Lëndë ndihmëse: 95%  
**Numri i regjistrimit:** AL: 163/1-21.11.2007  
KS: 025-117-2010/26.04.2010

**Formulimi:** Koncentrat i emulsionueshëm

**INSEKTICID SPECIFIK, LARVICID, SHUMË AKTIV, PËR LUFTIMIN E LARVAVE TË LEPIDOPTEREVE DHE DISA INSEKTEVE TË TJERA. PARAQET EDHE VEPRIM OVICID. PËRDORËT NË PROGRAMET E LUFTËS SË INTEGRUAR.**

## PËRDORIMI:

Kulturat bujqësore	Dëmtuesit	Doza	Vërejtje
<b>PATATE</b>	Bubureci i patates ( <i>Leptinotarsa decemlineata</i> ) Tenja ( <i>Phthorimaea operculella</i> )	300-400 ml/ha 400-600 ml/ha	Spërkatje me fillimin e shfaqjes së dëmtimit dhe përsëritje kur do nevojitet. 2-3 trajtime çdo 14 ditë.
<b>PERIME BIMË TË ARAVE</b>	<i>Helicoverpa/Heliothis, Spodoptera spp. Scrobipalpa aboduta, Acrolepiopsis assectella, Mamestra, Plutella, Crocidolomia, Hellula, Pieris, Frankliniella occidentalis</i>	400-600 ml/ha 200 ml/100 l ujë	2-3 trajtime çdo 14-21 ditë (për tripset çdo 7-10 ditë).
<b>PEMË FRUTORE</b>	<i>Cydia pomonella, Cydia molesta, Adoxophys spp., Caliroa cerasi, Minatriçet (Leucoptera spp.), Psylla pyri Aculus schlecterdari</i>	100 ml/100 l ujë	Spërkatje me fillimin e shfaqjes së dëmtimit dhe përsëritje kur do nevojitet. 3-4 trajtime çdo 15-30 ditë. Për pleshtat të shtohet dhe 1% vaj mineral.
<b>AGRUME</b>	<i>Phyllocoptruta oleivora</i> Krahëbardha ( <i>Aleurothrixus floccosus</i> ) Tenja minuese ( <i>Phyllocnistis citrella</i> )	75 ml/100 l ujë 150 ml/100 l ujë 100 ml/100 l ujë	2-3 trajtime çdo 14 ditë.
<b>ULLI</b>	Tenja ( <i>Prays oleae</i> )	100 ml/100 l ujë	
<b>HARDHI</b>	Tenjat ( <i>Lobesia botrana &amp; Clysia ambiguella</i> ) Flutura krahërozë ( <i>Sparganothis pilleriana</i> )	100 ml/100 l ujë	Spërkatje brenda 4-5 ditëve pas fillimit të fluturimeve, para vendosjes së vezëve dhe deri në fillimin e daljes së larvave.

**MËNYRA E PËRDORIMIT:** Me spërkatje, gjatë së cilës duhet të sigurohet lagje e mirë e bimëve.

**KOHA E TRAJTIMIT:** Match është një lloj aktiv si ndaj larvave të vogla (të reja) ashtu edhe ndaj të vjetrave (të ritura). Rekomandohet spërkatja kur numri i larvave arin kufirin kritik.

**SPËRKATJA E FUNDIT PARA VJELJES:** Perime të fam. Solanore 7 ditë, të fam. Kryqore 14 ditë, Patate 21 ditë, Pemë frutore dhe Agrume 28 ditë, Ulli 60 ditë, Hardhi 14 ditë dhe kulturat e tjera 28 ditë.

**FITOTOKSICITETI:** Match nuk është fitotoksik kur përdoret sipas rekomandimeve të mësipërme.

**PËRZIHET** me shumicën e insekticideve, fungicideve dhe rregullatorëve të rritjes.

**PERIUDHA E RUAJTJES:** 3 vjet. Preparati ruhet në shishe të mbyllura, në vende të thata e të ftohta. Evitoni ruajtjen në temperatura nën  $-5^{\circ}\text{C}$  dhe mbi  $35^{\circ}\text{C}$ .

### MASAT PARAMBROJTËSE

-Evitoni kontaktin me sytë dhe lëkurën. –Mbroni rrugët e frymëmarrjes duke përdorur mjetet mbrojtëse. -Mos hani dhe mos pini lëngje e duhan gjatë përdorimit. -Gjatë punës përdorni mjetet mbrojtëse. -Pas pune duart dhe fytyra duhet të lahen dhe rrobat të ndërrohen. -Lani pajisjet mbrojtëse para se ti ripërdorni.

### UDHËZIME PËR NDIHMËN E PARË DHE KËSHILLA PËR MJEKUN:

-Në rast kontakti me lëkurën hiqni menjëherë rrobat e ndotura, lani lëkurën me ujë të bollshëm e sapun. Lani rrobat e ndotura para se ti rivishni. -Në rast kontakti të preparatit me sytë i lani ato me ujë të bollshëm për disa minuta. -Në rast se merret me organet e frymëmarrjes nxireni të aksidentuarin në vende të ajrosura. –Në rast gëlltitje jepini në mënyrë të përsëritur karbon aktiv dhe ujë të bollshëm. Çojeni të aksidentuarin në spital dhe i tregoni mjekut etiketën e produktit. Antidot specifik nuk njihet. Mjekimi simptomatik. Tel. Urgjence: +44 1484 538 444.



**RELATIVISHT JO HELMUES PËR ZOGJË DHE PESHQIT. HELMUES PËR KRUSTACET**  
Mos ndotni ujrat me preparatin ose me ambalazhin e tij.

**TË RUHET NË VENDE TË SIGURTA DHE LARG FËMIJËVE.**

**PRODHUESI:** SYNGENTA Crop Protection AG,  
Basel, Switzerland  
Tel: +41 61 323 11 11 ; Fax: +41 61 323 12 12